Nga shhoqëritë kulturore, të formuara (pasShoqërisë së Shkronjave Shqip) jashtë vendit më e madhe konsiderohet ajo e:

- A) Bukureshtit
- B) Drita
- C) Dituria
- D) Stambollit

Pyetja 249.

Vlerësimi filozofik: “-S’ mund të ketë Shqipëri pa shqiptarë,/ s’ mund te ketë shqiptarë pa gjuhe shqipe,/ s’ mund të ketë gjuhë shqipe/ pa shkolla ku të mësohet shqip” i përket:

- A) Pashko Vasos
- B) Sami Frashërit
- C) Naim Frashërit
- D) Pandeli Sotirit

Pyetja 250.

Leja për botimin e revistës shqipe “Dituria” nga Porta e Lartë (1884) u dha nën ermin e patriotit:

- A) Petro Poga
- B) Pandeli Sotiri
- C) Kostandin Krustiforidhi
- D) Thimi Markos

Pyetja 251.

Shkolla private shqipe e Manastirit, më 1885 u hap nga:

- A) Pandeli Sotiri
- B) Koto Hoxhi

- C) Gjerasim Qiriazhi
- D) Thimi Marko

Pyetja 252.

Shkolla e parë shqipe e Korçës u çel më:

- A) 7 mars 1878
- B) 7 mars 1887
- C) 7 mars 1886
- D) 7 mars 1877

Pyetja 253.

Drejtori i parë i Mësonjtorës së parë të Korçës (1887) ishte:

- A) Pandeli Sotiri
- B) Thanas Sina
- C) Petro Nini Luarasi
- D) Nuçi Naçi

Pyetja 254.

Shkollën e parë shqipe për vajza në Korçë (23 tetor 1891) e themeloi:

- A) Sevasti Qiriazhi
- B) Polikseni Luarasi
- C) Franka Eftimi
- D) Gjerasim Qiriazhi

Pyetja 255.

Sipërfaqja e trojeve shqiptare në trungun etnik (ku shqiptarët përbënin shumicën dërrmuese të popullsisë) në gjysmën II të shek.XIX ishte

- A) 52 mijë km²
- B) 62 mijë km²
- C) 72 mijë km²
- D) 82 mijë km²

Pyetja 256.

Cili nga dokumentet drejtuar Portës së Lartë (1896-1897) për çështjen e autonomisë u hartua nga atdhetarët shqiptarë, për herë të parë, brenda vendit?

- A) Momerandumi i Ibrahim Temos (korrik 1896)
- B) Promemorja e Dervish Himës (maj 1896)
- C) Thirrja “Në emër të popullit shqiptar” (janar 1898)
- D) Program i atdhetarit Preng Doçi (pranverë 1897)

Pyetja 257.

Rezoluta (*Kranameja*) me 11 pika, publikuar më 29 janar 1899 i përket:

- A) Beslidhjes Shqiptare (shkurt 1897)
- B) Komitetit Shqiptar të S.Frashërit (pranverë 1897)
- C) Thirrjes së shoqërive shqiptare të mërgimit (janar 1898)
- D) Kuvendit të Pejës (janar 1899)

Pyetja 258.

Traktati politik i S.Frashërit "*Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë*", (mars 1899), parashtrori për herë të parë, në historinë e mendimit politik çështjen e:

- A) Shkëputjes së plotë të Shqipërisë nga Perëndoria Osmane
- B) Statusit të autonomisë së Shqipërisë brenda Perëndorisë Osmane
- C) Projektit kushtetues të shtetit të pavarur shqiptar
- D) Luftës me armë për çlirim nga zgjedha turke

Pyetja 259.

Programin politik për Lëvizjen Kombëtare, Ismail Qemali e publikoi për herë të parë në:

- A) Promemorjen drejtuar sulltan Abdyl Hamitit
- B) Intervistën për gazetën e njohur italiane "Tribuna"
- C) Thirrjen (Vllëzërve Shqiptarë) botuar në revistën Albania
- D) Gazetën e vet "Le salut d'Albanie" (Shpëtimi i Shqipërisë)

Pyetja 260.

Sipas marrëveshjes austro-italiane (1901-1912), e njohur si akordi i "ekuilibrit në Adriatik", Shqipëria konsiderohej zonë e ndikimit:

- A) Austriak
- B) Italian
- C) Austro-italian
- D) Shteteve të tjera

Pyetja 261.

Prifti e poeti atdhetar, Papa Kristo Negovani u bë viktimë (shkurt 1905) e komiteteve terroriste:

- A) Greke
- B) Serbe
- C) Bullgare
- D) Turke

Pyetja 262. V)

Komiteti i parë i fshehtë "*Për lirinë e Shqipërisë*", (fillim shek.XX) që shënoi fillimin e organizatave të përgjithëshme kombëtare ishte:

- A) Komiteti i Janinës

- B) Komiteti i Pejës
- C) Komiteti i Manastirit
- D) Komiteti i Dibrës

Pyetja 263. V)

Komiteti i fshehtë “Për lirinë e Shqipërisë” , i formuar në Manastir (shkurt 1905) ktursoje nga :

- A) Feim Zavalani
- B) Gjergj Qiriazhi
- C) Sejfi vllamas (Novosela)
- D) Bajram (Bajo) Topulli

Pyetja 264.

Është konsideruar si manifest politik i Rilindjes Kombëtare vepra:

- A) E vërteta mbi Shqipërinë e shqiptarët” (Pashko Vasa)
- B) Shqipëria ç’ka qënë, ç’është e ç’do të bëhetë” (Sami Frshëri)
- C) Shqypnia dhe Shqyptarët” (Pashko Vasa)
- D) Shkronjëtarja e gjuhësë shqip” (Sami Frshëri)

Pyetja 265.

Hapin e pare, shtypi shqiptar e hodhi me botimin e :

- A) Revistës Drita (Sami e Naim Frashëri)
- B) Revistës “Shqiptari”(Nikolla Naço)
- C) Gazetës “Flamuri i Arbërit” (jeronim De Rada)
- D) Revistyës “Albania”(Faik Konca)

Pyetja 266.

Temën e shkëputjes së plotë të Shqipërisë nga Turqia e trajtoi më gjerë:

- A) Revista “Albania”
- B) Revista “Kombi”
- C) Revista “Shqipëria”
- D) Kalendari kombiar

Pyetja 267.

Për veprën e tij letrare, është pagëzuar “apostull i shqiptarizëms”:

- A) Shtjefën Gjeçovi
- B) Naim Frashëri
- C) Andon Zako Çajupi
- D) Ndre Mjeda

Pyetja 268,

Klubi i parë kombëtar, i krijuar pas vendosjes së regjimit xhonturk (korrik 1908) ishte:

- A) Klubi i Elbasanit
- B) Klubi “Bashkimi” i Manastirit
- C) Klubi i Filatit
- D) Klubi i Kumanovës

Pyetja 269.

Klubit kombëtare të vitit 1908, dallonin nga komitetet “Për lirinë e Shqipërisë sepse; kishin si objektiv:

- A) Ngritjen e përhapjen e shkollave shqipe
- B) Dhënien e mësimt të gjuhës amtare në shkollat e huaja
- C) Krijimin e çetave të armatosura në tërë vendin
- D) Përdorimin e një alfabeti të vetëm për gjuhën shqipe

Pyetja 270.

Gazeta e pare, e botuar më nismën e klubeve kombëtare (1908) është:

- A) Gazeta “Koha” (Mihal Grameno)
- B) Gazeta “ Bashkimi i Kombit”, (Fehim Zavalani)
- C) Gazeta “Korça” (Sami Pojani)
- D) Zgjimi i Shqipërisë (Abdyl Bakiu)

Pyetja 271.

Cili nga organet e shtypit (fundi shek XIX-fillimi shek.XX) dha ndimesë më të madhe për vendosjen e njëhësimin e alfabetit të gjuhës shqipe:

- A) “Shqypeja e Shqypenis” (Sofje)
- B) “Shqipëtari”(Stamboll)
- C) “Dielli” (Boston)
- D) “Albania”(Bruksel-Londër)

Pyetja 272.

Në Kongresin e Manastirit (14-22 nëntor 1908) për njësimin e alafabeti shqip merrnin pjesë, gjithësej:

- A) 40 delegatë
- B) 30 delegatë
- C) 50 delegatë
- D) D) 60 delegatë

Pyetja 273.

Kongresi Kombëtar i Elbasanit (2-8 shtator 1909) u thir me nismën e:

- A) Klubit të Manastirit
- B) Klubit të Selanikut

- C) Klubit “Bashkimi”
- D) Klubit “Vllaznia”

Pyetja 274.

Vendimin për hapjen e një shkolle normale në Shqipëri e mori:

- A) Kongresi i Manastirit (14-22 nëntor 1908)
- B) Kongresi i Dibrës (23-29 korrik 1909)
- C) Kongresi i Elbasanit (2-8 shtator 1909)
- D) Kongresi i Dytë i Manastirit (2-3 prill 1910)

Pyetja 275.

Drejtori i parë i shkollës Normale të Elbasanit u emrua:

- A) Aleksandër Xhuvani
- B) Simon Shuteriqi
- C) Petër Dodbiba
- D) Luigj Gurakuqi

Pyetja 276.

Tregues kryesor i lindjes së ekonomisë së tregut në qytetin shqiptar (mesi shek XIX) ishte:

- A) Përqëndrimi i popullsisë në fshat
- B) Shturja e disiplinës esnafore
- C) Heqja e monopolit esnafor mbi prodhimin
- D) Zhvillimi i ekonomisë monetare

Pyetja 277.

Rruga e rritjes së çifligjeve (pronës çifligare), me anë të përvetësimit të tokave vakante gjatë shek XIX, u vu re më shumë në:

- A) Shqipërinë Veriperëndimore
- B) Shqipërinë Juglindore,
- C) Shqipërinë Ulët
- D) Shqipërinë Veriore

Pyetja 278.

Në fillim të shek XX, në krye të pronarëve çifligare qëndronte Familja e:

- A) Vlorajve
- B) Toptanëve
- C) Vërlacëve
- D) Vrionëve

Pyetja 278.

Promemorja prej 4 pikash, drejtuar qeverisë turke përbëntë Aktin Dytë Kryesor të:

- A) Kongresit Dytë të Manastirit (pril 1910)
- B) Kongresit të Elbasanit (shtator 1909)
- C) Klubit Arsimor të Shkupit (vjeshtë 1909)
- D) Klubit “Bashkimi” të Manastirit (vjeshtë 1909)

Pyetja 279.

Në Betejën e Kaçanikut (30 prill 1910) Kryengritësit shqiptarë i udhëqijate:

- A) Isa Boletini
- B) Idriz Seferi
- C) Halil Mehmeti
- D) Nexip Draga

Pyetja 280.

Në betejën për marrjen e Grykës së Kaçanikut (30 prill 1910), Turgut Pashës angazhoi;

- A) 20 000 forca
- B) 25 000forca
- C) 30 000 forca
- D) 35 000 forca

Pyetja 281.

Cila nga qeveritë ballkanike kundërshtoi kërkesën për armatime (Kryengritja e vitit 1910) me pretekstin se shqiptarët mbanin të fshehtë planin e saj?

- A) Mali i Zi
- B) Bullgaria
- C) Greqia
- D) Serbia

Pyetja 282.

Cila nga Fuqitë e Mëdha e mbështeti plotësisht dhunën dhe terrorin e të shtrisë turke të vitit 1910:

- A) Austro-Hungaria
- B) Rusia
- C) Gjermania
- D) Italia

Pyetja 283.

Këkesën që “..Shqipëria të bëjë vetqeverimtare” (*autonome*-nën. autori), udhëheqësit e Kryengritjes së Veriut (1911) e parashtruan në :

- A) Mbledhen e organizuar në Cetinjë (30 mars1911)
- B) Thirrjen drejtuar shqiptarëve të jugut (15 prill 1911)

- C) Proklamata shqip, frëngjisht, italisht (1 maj 1911)
- D) Sulmin për marrjen e qytetit Tuz (28 marS 1911)

Pyetja 284.

Kuvendi i Përgjithshëm i krerëve shqiptarë në Greçë (23 qershor 1911) u mbajt me nismën e:

- A) Komitetit të Podgoricës
- B) Komitetit të Barit
- C) “Shoqëria e Zezë për Shpëtim”
- D) Komitetit të Barit (Dega Korfuz)

Pyetja 285.

Dokumenti, i njohur me emrin “Momerandumi i Greçës”, veçohet në histori për :

- A) Programin e ri autonomist
- B) Format e reja të organizimit kryngritës
- C) Jehonën ndërkombëtare
- D) Ndërgjegjen politike të shqiptarëve

Pyetja 286.

Nismën diplomatike për ndërhyrje kolektive pranë Portës së Lartë. në përkrahje të kërkesave të shqiptarëve, më 26 qershor 1911 e mori:

- A) Gjermania
- B) Franca
- C) Anglia
- D) Austro- Hungaria

Pyetja 287.

Memorandumin në mbështetje të “Memorandumit të Greçës” (qershor 1911) në Jug miratoi:

- A) Komiteti i Korfuzit
- B) Shoqëria e Zezë për Shpëtim”
- C) Kuvendi në Manastirin e Cepas
- D) Komiteti Shqiptar i Vlorës

Pyetja 288.

Nevoja për organizimin e një Kryengritje të Përgjithëshme, si rrugë e vetme për çlirimin e vendit nga pushtuesit, u shtrua për herë të parë nga:

- A) Kuvendi i Krasniqes (21 prill 1912)
- B) Mbledhja e Shalës (6 maj 1912)
- C) Kuvendi i Junikut (21-25 maj 1912)
- D) Mbledhja e Taksimit (12 janar 1912)

Pyetja 289.

Marrëveshja shqiptaro-turke e 18 gushtit 1912, u nënshkrua mbi bazën e:

- A) Momerandumit të Greçës
- B) Programit autonomist të Junikut
- C) “14 pikat e Hasan Prishtinës”
- D) Programit autonomist të Taksimit

Pyetja 290.

Në Kuadrin e Aleancës Ballkanike, coptimi i tokave shqiptare u sanksionua për herë të parë::

- A) Marrëveshja bullgaro - serbe (mars 1912)
- B) Marrëveshja bullgaro - greke (maj 1912)
- C) Marrëveshja e Malit të Zi me Bullgarinë (gusht 1912)
- D) Marrëveshja midis Austro-Hungarisë me Rusinë (shtator 1912)

Pyetja 291.

Ruga e zgjidhjes së Krizës Ballkanike (1912-1913) me luftë të armatosur u propozua nga:

- A) Shoqëria e Zezë për Shpëtim (tetor 1912)
- B) Mbledhja e Bostonit (6 tetor 1912)
- C) Mbledhja e Shkupit (14 tetor 1912)
- D) Mbledhja e Bukureshtit (5 nëntor 1912)

Pyetja 292.

Nismën për një veprim të ri politik, për zgjidhjen e çështjes kombëtare, I.Qemali dhe L.Gurakuqi e parashtruan për herë të parë në:

- A) Mbledhjen e Shkupit (14 tetor 1912)
- B) Mbledhjen e Bukureshtit 95 nëntor 1912
- C) Gazetën Liri e Shqipërisë (tetor 1912)
- D) Deklaratën e Triestes (19 nëntor 1912)

Pyetja 293.

Deklaratën se, me mbritjen në Shqipëri do të shpallej Pavarësia e Shqipërisë, I.Qemali e bëri publike në:

- A) Mbledhjen e Bukureshtit (5 nëntor 1912)
- B) Takimin me Ambasadorin Anglez (10 nëntor 1912)
- C) Takimin e Triestes (19 nëntor 1912)
- D) Takimin e Vjenës (8 nëntor 1912)

Pyetja 294.

Në mbledhjen e parë të Kuvendin Kombëtar të Vlorës (28 nëntor 1912), morën pjesë:

- A) 36 delegatë
- B) 37 delegatë

- C) 38 delegatë
- D) 39 delegatë

Pyetja 295.

Pas dorëheqjes së I. Qemalit, kryetar i Kuvendi Kombëtar i Vlorës u zgjodh:

- A) Luigj Gurakuqin
- B) Mithat Frashërin
- C) Vehbi Agolli
- D) Dom Nikoll Kaçorri

Pyetja 296.

Qeveria e Ismail Qemalit kishte në përbërje:

- A) 7 anëtarë
- B) 8 anëtarë
- C) 9 anëtarë
- D) 12 anëtarë

Pyetja 297.

Me shpërthimin e konfliktit ballkanik (1912-1913), cilat ishin tre Fuqitë e Mëdha më të interesuara për çështjen shqiptare?

- A) Italia, Anglia, Austro-Hungaria
- B) Italia, Rusia, Anglia
- C) Austro-Hungaria, Italia, Franca
- D) Austro-Hungaria, Italia, Rusia

Pyetja 298.

Seanca e parë e Konferencës së Londrës (17 dhjetor 1912) vendosi:

- A) Krijimin e shtetit autonom shqiptar
- B) Krijimin e shteti autonom shqiptar nën sovranitetin e sulltanit
- C) Krijimin e shtetit të pavarur shqiptar
- D) Krijimin e Shqipërisë autonome asnjënjëse.

Pyetja 299.

Vendimi përfundimtar i Konferencës së Londrës (11 gusht 1913) mbi kufijtë e Shqipërisë, la të papërcaktuar çështjen e:

- A) Krahinës së Gjirokastrës
- B) Krahinës së Korçës
- C) Ishullit të Sazanit
- D) Kufirit bregdetar

Pyetja 300.

Vendimin mbi shpalljen e Shqipërisë: “Principatë autonome dhe e trashëgueshme”, Konferenca e Londrës e mori më:

- A) 17 dhjetor 1912
- B) 20 maj 1913
- C) 30 maj 1913
- D) 29 korrik 1913

Pyetja 301.

Akti kryesor ndërkombëtar i Konferencës së Londrës, që njohu pavarësinë e Shqipërisë konsiderohet:

- A) Vendimi i 17 dhjetorit 1912
- B) Vendimi i 29 korrikut 1913
- C) Vendimi i 11 gushtit 1913
- D) Vendimi i 12 gushtit 1913

Pyetja 302.

Në caktimin e kufijve të Shqipërisë, Konferenca e Londrës (1913) diskutoi mbi bazën e projekt-hartës të paraqitur nga:

- A) Austro-Hungaria
- B) Rusia
- C) Austro-Hungaria e Italia
- D) Qeveria e Vlorës

Pyetja 303.

Cila nga Fuqitë e Mëdha e mbështeti idenë se, qeveria e Vlorës mund të shërbente si bazë e organizimit të shtetit shqiptar?

- A) Franca
- B) Anglia
- C) Austro-Hungaria
- D) Rusia

Pyetja 304.

Sipas vendimeve të Konferencës së Londrës, popullsia (vetëm shqiptare) e mbetur jashtë trungut etnik në vitin 1912 llogaritej në:

- A) 622 mijë banorë
- B) 802 mijë banorë
- C) 812 mijë banorë
- D) 822 mijë banorë

Pyetja 305.

Qyteti më i madh në Shqipëri (me 25 mija banorë) më 1912 ishte:

- A) Elbasani
- B) Shkodra
- C) Gjirokastra
- D) Berati

Pyetja 306.

Në strukturën e pronësisë çifligare mbi tokën, sipërfaqen më të madhe të saj (36 %) më 1912 e zotronin:

- A) Prinarët çifligarë
- B) Shteti
- C) Institucionet fetare
- D) Pronëtarët e vegjël

Pyetja 307.

Rolin vendimtar në dorëzimin e qytetit të Shkodrës trupavae malazese 22-23 prill 19130 e luajti:

- A) Forca ushtarake e Malit të Zi
- B) Qëndrimi atdhetar i malësorëve
- C) Marrveshja e fshehte midis Esat Toptanit e Malit të Zi
- D) Dobësit e garnizonit turk të Hasan Riza Pashës

Pyetja 308.

“Përlindja e Shqipërisë” (vjeshtë 1913) konsideronte si “...më të bukurin urdhër që ka dhënë qeveria (Vlorës-nën autori) gjer më sot”:

- A) Krijimin e “Zyrës së Shtatmadhorisë”
- B) Ngritjen e organeve të sigurimit public
- C) Rregulloren e Milicisë shqiptare
- D) Shpalljen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare

Pyetja 309.

“Kanui i përtashëm i administratës civile të Shqipërisë” (nëntor 1913) ishte akt ligjor themelor i:

- A) Kuvendit të Vlorës
- B) Pleqësisë së Vlorës
- C) Qeverisë së Vlorës
- D) Komisionit Ndërkombëtar të kontrollit

Pyetja 310.

Cili nga personalitetet e njohura, u rreshtua në krah të lëvizjes separatiste të Esat Toptanit, për krijimin e Pleqësisë së Shqipërisë së Mesme?

- A) Luigj Gurakuqi
- B) Hasan Prishtina

- C) Faik Konica
- D) Bajram Curri

Pyetja 311.

Në postin e anëtarit të shtatë, Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (tetor 1913) kundërshtoi kandidaturën e :

- A) Myfit Libëhoves
- B) Luigj Gurakuqit
- C) Eqerm Bej Vlorës
- D) Hasan Prishtinës

Pyetja 312.

Në përgatiten e Kryengritjes së vitit 1911, cili nga komitetet atdhetare bëri një punë më të organizuar për sigurimin e armëve e municioneve:

- A) Komiteti Barit
- B) Komiteti Pro Albania
- C) Komiteti i Podgoricës
- D) Komiteti i Manastirit

Pyetja 313.

Personaliteti më i fuqishëm i qeverisë së Turhan pashë Përmetit (mars 1914) ishte:

- A) Myfid Libohova
- B) Hasan Prishtina
- C) Esat Toptani
- D) Preng B Doda

Pyetja 314.

“Statuti organik i Shqipërisë” (10 prill 1914) u hartua nga:

- A) Qeveria e Ismail Qemalit
- B) Pleqësia e Shqipërisë së Mesme
- C) Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit
- D) Qeveria e Princ Vidit

Pyetja 315.

Traktati i Fshehtë i Londrës (26 prill 1915) u nënëshkrua ndërmjet:

- A) Bllokut Qëndror dhe Antantës
- B) Antantës dhe Italisë
- C) Italisë dhe Austro-Hungarisë
- D) Greqisë dhe Serbisë

Pyetja 316.

Krahina Autonome e Korçës (10 dhjetor 1916) udhëhiqej nga:

- A) Senati
- B) Këshilli qeveritar
- C) Themistokli Gërmenji
- D) Autoritetet ushtarake franceze

Pyetja 317.

Konçensionin për krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë (1925) e mori:

- A) Grupi financiar Italian
- B) Komiteti Financiar i Lidhjes së Kombeve
- C) Grupi financiar anglez
- D) Grupi financiar jugosllav

Pyetje 318.

Është vlerësuar si program i Lëvizjes Kombëtare në vitet 1914-1918:

- A) Programi i “Federatës” Vatra (F.Noli)
- B) Program i gazetës “Populli”(S.Nivica)
- C) Programi i Komitetit Kosovës (Hoxhë Kadri Prishtina)
- D) Program i Shoqërisë “Bashkimi” (Avni Rustemi)

Pyetje 319.

Kongresi i Durrësit (25 dhjetor 1919) vendosi:

- A) Krijimin e Këshillit Shqiptar
- B) Krijimin e Komitetit Shqiptar
- C) Krijimin e qeverisë Përkohshme T. Pashë Përmetit
- D) Krijimin e qeverisë së Esat Toptanit

Pyetja 320.

Momerandumi i tre Fuqive të Mëdha (ShBA, Anglia Franca) , më 9 dhjetor 1919, i njohu Italisë:

- A) Stausin e Protektoratit mbi Shqipërinë
- B) Stausin e mandatit mbi Shqipërinë
- C) Stausin e sovranitetit të plotë mbi Vlorën
- D) Stausin e mandatit mbi “Shqipërinë Myslimane”

Pyetja 321.

Cila nga marrveshjet dypalëshe sanksionoi mandatin italian mbi Shqipërinë?

- A) Momerandumi i tre Fuqive të Mëdha (ShBA, Angli, Francë) (9 dhjetor 1919)
- B) Marrëveshja italo-greke (Tittoni-Venizellos) (29 korrik 1919)
- C) Marrëveshja e qeverisë së Durrsit me qeverinë Romës (20 gusht 1919)
- D) Kompromisi i tre kryemisnistrave (Francë, Angli, Itali) (13 janar 1920)

Pyetja 322.

Pikpamjen për një princ të huaj (me origjinë italiane) në krye të shtetit shqiptar, në Konferencën e Paqes së Parisit (1919) e mbronte:

- A) Fraksioni Konica-Turtulli
- B) Delegacioni i Durrësit me kryetar Turhan Pashën
- C) Delegacioni i Durrësit me kryetar imzot Luigj Bumçin
- D) Përfaqësuesit e kolonive

Pyetja 323.

Kryetar i Kongresit të Lushnjes (28-31 janar 1920) u zgjodh:

- A) Aqif Pashë Elbasani
- B) Sotir Peci
- C) Ahmet Zogu
- D) Eshref Frashëri

Pyetja 324.

Këshilli i Lartë (me 4 veta), i ndërtuar sipas parimit të ndarjes fetare, doli nga :

- A) Kongresi i Durrësit (dhjetor 1919)
- B) Statuti organik i Shqipërisë (prill 1914)
- C) Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (tetor 1913)
- D) Kongresi i Lushnjes (janar 1920)

Pyetja 325.

Këshilli i lartë i dalë nga Kongresi i Lushnjes ishte organ me atributet:

- A) Kryeministrit
- B) Kryetarit të shtetit
- C) Trupës legjilative
- D) Shpërndarjes së Këshillit Kombëtar

Pyetja 326.

Cila nga vendimarrjet e mëposhtme nuk i takon Kongresit të Lushnjes (janar1920)?

- A) Zgjedhja e Këshillit të Lartë
- B) Zgjedhja e Qeverisë së S.Delvinës
- C) Zgjedhja e Këshillit Kombëtar
- D) Zgjedhja e Asamblesë Kushtetuese

Pyetja 327.

Fillimet e jetës parlamente në Shqipëri i shënoi:

- A) Pleqësia e Vlorës (dhjetor 1912)

- B) Asambleja Kombëtare (prill 1914)
- C) Këshilli Kombëtar (mars 1920)
- D) Pleqësia (Senati) i Durrësit (dhjetor 1919)

Pyetja 328.

Tirana u caktua kryeqytet i Shqipërisë më:

- A) 11 shkurt 1920
- B) 11 shkurt 1921
- C) 11 shkurt 1922
- D) 11 shkurt 1923

Pyetja 329.

Kuvendin e Braçallas, që shpalli fillimin e luftës kundër pushtuesëve Italian (20 maj 1920) e kryesonte:

- A) Qazim Koculi
- B) Osman Haxhiu
- C) Ahmet Lepenica
- D) Qazim Koculi

Pyetja 330.

Protokolli shqiptaro-italian i Tiranës (2 gusht 1920), la jashtë sovranitetit të shtetit shqiptar

- A) Vlorën
- B) Gjirokastrën
- C) Korçën
- D) Sazanin

Pyetja 331.

Shqipëria u bë anëtare e Lidhjes së Kombeve më:

- A) 17 nëntor 1920
- B) 17 dhjetor 1920
- C) 17 nëntor 1921
- D) 17 dhjetor 1921

Pyetja 332.

Lëvizja separatist e Gjon Markagjonit (Republika e Mirditës) e 17 korrikut 1921 u nxit nga:

- A) Qeveria e Romës
- B) Qeveria e Athinës
- C) Qeveria e Beogradit
- D) Qeveria e Malit të Zi

Pyetja 333.

Konsiderohet si, viti i përmbylljës së luftës së popullit tone, për të rifituar pavarësinë:

- A) Viti 1920
- B) Viti 1921
- C) Viti 1924
- D) Viti 1925

Pyetja 334.

Qeveria e Iliaz Vrionit, e dalë nga zgjedhjet e para palamentare (pranverë 1921) ishte:

- A) Qeveri e Partisë Popullore
- B) Qeveri e Partisë Partisë Përparimtare
- C) Qeveri koalicioni nga të dy partitë
- D) Qeveri jashtë partiake

Pyetja 335.

Akti i parë diplomatik, që sanksionoi njohjen ndërkombëtare të qeverisë shqiptare ishte:

- A) Pranimi në Lidhjen e Kombeve (dhjetor 1920)
- B) Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve (nëntor 1921)
- C) Vendosja e marrdhënieve diplomatike më Anglinë (nëntor 1921)
- D) Vendosja e marrdhënieve diplomatike me Francën (nëntor 1921)

Pyetja 336.

Kriza qeveritare e dhjetorit 1921 u zgjidh:

- A) Me krijimin e grupit politik “Bashkimi i Shenjtë”
- B) Me krijimin e qeverisë teknike të I.Kosturit
- C) Me krijimin e Këshillit Lartë të ri
- D) Me votbesimin e qeverisë së Xhafer Ypit

Pyetja 337.

Për herë të parë karakterin laik të shtetit shqiptar e sanksionoi:

- A) Qeveria e Ismail Qemalit (1913)
- B) Satuti Organik i Shqipërisë (1914)
- C) Statuti i Lushnjes (1920)
- D) Satuti i Zgjeruar i Lushnjes (1922)

Pyetja 338.

Federata “Atdheu” (prill 1921) u krijua me nismën:

- A) Halim Xhelos
- B) Avni Rustemit
- C) Dr. Sezai Çomos
- D) Fuad Asllani

Pyetja 339.

Në dhjetor 1922, paraqiti letrat krendenciale në Këshillin e Lartë të Shqipërisë

- A) Përfaqësuesi i ShBA-s
- B) Përfaqësuesi i Britanisë së Madhe
- C) Përfaqësuesi i Italisë
- D) Përfaqësuesi i Francës

Pyetja 340.

Qeveria e formuar pas zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese (shkurt 1924) e kryesonte;

- A) Sami bej Vrioni
- B) Myfid Bej Libohova
- C) Shefqet bej Verlaci
- D) Iliaz bej Vrioni

Pyetja 341.

Kriza politike e fillimi të vitit 1924, degjeneroi në kryengritje të armatosur:

- A) Pas atentatit kundër A.Zogut (23 shkurt 1924)
- B) Pas dështimit të komisionit miks për formën e regjimit (mars 1924)
- C) Pas vrasjes së dy amerikanëve në Mamurras (prill 1924)
- D) Pas atentatit ndaj Avni Rustemit (20 prill 1924)

Pyetja 342.

Vrasjen e Avni Rustemit (20 prill 1924), organet e shtypit demokartik e trajtuan më tepër:

- A) Si veprim me karakter politik
- B) Si hakmarrje personale e A.Zogut
- C) Si luftë midis grupeve klanore
- D) Si dhunë kundër refomave të reja

Pyetja 343.

Shkaku më kryesor, që e shtyu opozitën demokratke me në krye F.Nolin drejt kryengritjes së armatosur vlerësohet:

- A) Mospranimi kërkesës për zhvendosjen e Asamblesë në Vlorë
- B) Paaftësia e qeverisë për të kapur e ndëshkuar atentatorët
- C) Mbështetja e opozitës nga garnizonet ushtarake.
- D) Formimi i qeverisë së Iliaz bej Vrionit

Pyetja 344.

Detyra më e rëndë dhe më e rëndësishme e qeverisë F.Nolit konsiderohet:

- A) Çarmatimi i përgjithshëm i popullsisë

- B) Çrrënjësja e feudalizmit nga jeta ekonomike
- C) Vendosi e rendit public dhe sigurisë
- D) Reformimi i administratës shtetërore

Pyetja 345.

Cila nga këto qeveri i akordoi njohje zyrtare qeverisë së Fan Nolit:

- A) Qeveria e Britanisë së Madhe
- B) Qeveria e Bashkimit Sovjetik
- C) Qeveria e SHBA-s
- D) Qeveria e Italisë.

Pyetja 346.

Faktori më kryesor që çoi në dështimin e qeverisë së Fan S. Nolit (dhjetor 1924 ishte:

- A) Përçarja politike
- B) Izolimi ndërkombëtar
- C) Moszbatimi i Refomës Agrare
- D) Agresioni i forcave të huaja

Pyetja 347.

Asambleja Kushtetuese (1923), e mbledhur në janar 1925, vendosi që Shqipëria të qeverisej në formën e:

- A) Republikës parlamentare
- B) Republikë presidenciale
- C) Mbretërisë shqiptare
- D) Monarkisë kushtetuese

Pyetja 348.

Në politikën e Jashtëme, Zogu President përcaktoi si partner kryesor:

- A) Marrdhëniet me Jugosllavinë
- B) Marrdhëniet me Britaninë e Madhe
- C) Marrdhëniet me Italinë
- D) Marrdhëniet me ShBA

Pyetja 349.

Kushti më i rëndë për dhënie të huas SVEA prej 50 milion franga nga shteti italian ishte:

- A) Rivlerësimi i liretës
- B) Shlyerja për 40 vjet
- C) Kamata vjetor 7.5%
- D) Pagesa e menjëhershme

Pyetja 350.

Cila është pika specifike e Paktit Ushtarak (23 gushtit 1925) midis Zogut dhe Musolinit?

- A) Parshikonte mbrojtje ushtarake të ndërsjellë
- B) Parshikonte krijimin e shtabit të përbashkët
- C) Ishte pakt korrespondence midis dy personaliteteve
- D) Përfshinte zgjidhjen e çështjes etnike të shqiptarëve

Pyetja 351.

Për t'i bërë ballë presionit politik të Italisë, për nënshkrimin e një pakti protektorat (1926), Zogu fillimisht kërkoi ndihmë nga:

- A) Lidhja e Kombeve
- B) Britania e Madhe
- C) Jugosllavia
- D) Shtet e Bashkuara të Amerikës.

Pyetja 352.

Ku qëndron dallimi formal i Paktit II të Tiranës (22 nëntor 1927) nga Pakti I (27 nëntor 1926)?

- A) Sepse u quajt "Traktat i Aleancë mbrojtëse"
- B) Sepse legjitimonte ndërhyrjen ushtarake të Italisë
- C) Sepse mori formën e maskuar të "reciprocitetit"
- D) Sepse kufizoi sovranitetin e shtetit shqiptar

Pyetja 353.

Orvatja për t'i bërë atentat A.Zogut në vitin 1931 u bë nga;

- A) Organizata Bashkimi Kombëtar
- B) Organizata Komiteti i Çlirimit Nacional
- C) Organizata Grupi Indipendent i Zarës
- D) Organizata Grupi Komunist i Moskës

Pyetja 354.

Në ditën që u shpall Mbreti i Shqiptarëve, A.Zogun nuk u përshëndet nga:

- A) Krerët e Komunitetit Musliman
- B) Krerët e autoriteteve lokale
- C) Krerët e Kishës Katolike
- D) Krerët e Kishës Ortodokse

Pyetja 355.

Cila nga këto qeveri të huaja nuk e njohu monarkinë zogiste?

- A) Qeveria britanike
- B) Qeveria turke
- C) Qeveria italiane

D) Qeveria jugosllave

Pyetja 356.

Statuti themeltar i monarkisë (1 dhjetor 1928) krijoi për herë të parë në historinë e shtetit:

- A) Parlamentin
- B) Oborin mbretëror
- C) Senatin
- D) Këshillin e Shtetit

Pyetja 357.

Rëndësi më të madhe për forcimin e shtetit, në periudhën monarkiste pati:

- A) Reforma kushtetuese
- B) Reforma legjislative
- C) Reforma Agrare
- D) Reforma fetare

Pyetja 358.

Kriza e marrdhënieve italo-shqiptare në fillim të viteve '30 kishte si burim kryesor:

- A) Depresionin e Madh ekonomik botror
- B) Mospërsëritjen e Paktit I të Tiranës nga Zogu
- C) Atentatin kundër Zogut në Vjenë
- D) Kundërshtimin e moratoriumit për shtyrjen e borxhit të SVEA-s.

Pyetja 359.

Cila nga organizatat antizogiste të viteve '30, (shek.XX) u nxit dhe u subvencionua nga qeveria jugosllave?

- A) Organizata e Fshehtë e Tiranës
- B) Komiteti i Çlirimit Nacional
- C) Organizata e Fshehtë e Vlorës
- D) Grupet komuniste shqiptare

Pyetja 360.

Në planin e tij, Ministri i Jashtëm i Italisë G.Çiano shpalli si rrugë më të parapëlqyer pushtimin e Shqipërisë

- A) Kolonizimin ekonomik (rruga paqësore)
- B) Coptimin e tokave shqiptare ndërmjet Italisë e Jugosllavisë
- C) Nënshtrimin politik të shtetit shqiptar
- D) Aneksimin e plotë nëpërmjet “bashkimit personal”

Pyetja 361.

Cila nga rrymat e mendimit filozofik (vitet '30, shek XX) shtroi nevojën e vendosjes së “diktaturës së ndritur” në Shqipëri:

- A) ‘Neoshqiptarizma’
- B) Rryma e “të rinjëve”
- C) Rryma e “të vjeëtërve”
- D) Rryma fetare

Pyetja 362.

Cila nga rrymat idologjike të viteve '30 (shek.XX) u bë zëdhënëse e aleancës italo-shqiptare dhe i thurte lavde fashizmit e Musolinit?

- A) Rryma e ideologëve të “rinjë”
- B) “Neoshqiptarizma”
- C) Rryma e ideologëve “të vjetër”
- D) Rryma e ideologëve të majtë

Pyetja 363.

Cili nga personalitetet e mëposhtme vlerësohet si mendimtar dhe iluminist i Pavarsisë?

- A) Mithat Frashëri (Lumo Skëndo)
- B) Migjeni
- C) Fan Noli
- D) Faik Konica

Pyetja 364.

Revista “Bota e Re” (vitet '30 shek.XX) u bë shprehese e:

- A) Mendimit klerikal
- B) Rrymës së ideologëve “të vjetër”
- C) Rrymës së ideve demokratike (të majta)
- D) Rrymës së “diktaturës së ndritur”

Pyetja 365.

Vepra “*Poema e Mjerimit*”, e njohur për kritikën sintezë kundër mjerimit dhe shkaktarëve të tij, është shkruajtur nga :

- A) Aleksandër Stavre Drenova (Asdreni)
- B) Millosh Gjergj Nikolla (Migjeni)
- C) At Gjergj Fishta
- D) Fan Stilian Noli

Pyetja 366.

Historiani që zuri një vend nderi në historiografinë shqiptare të viteve të Pavarsisë konsiderohet:

- A) Xhaferr Belegu
- B) Ndoc Nikaj

- C) Fan S. Noli
- D) Teki Selenica

Pyetja 367.

Në krye të kryengritjes antiserbe, për çlirimin e Peshkopisë (20-23 shtator 1913) ishte:

- A) Bajram Curri.
- B) Isa Boletini
- C) Hasan Prishtina
- D) Elez Isufi

Pyetja 368.

Ndihma efektive e Qeverisë së Vlorës për Kryengritjen e Dibrës (shtator 1913) u sabotua më shumë nga:

- A) Lëvizja separatiste e E.Toptanit
- B) Status i asnjësisë i K.Londrës
- C) Pushtimi i tokave të Jugut nga Greqia
- D) Presioni i Malit të Zi për të rimarë Shkodrën.

Pyetja 369.

Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” u themelua në Shkodër më:

- A) 1 maj 1918
- B) 1 maj 1919
- C) 1 maj 1920
- D) 1 MAJ 1921

Pyetja 370.

Kryetar i “Komitetit Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” ishte:

- A) Hasan Prishtina
- B) Bajram Curri
- C) Hoxha Kadri Prishtina
- D) Bedri Pejani

Pyetja 371.

Praninë e Komisionit të Komitetit të Kosovës, në Konferencën e Paqes së Parisit e pengoi:

- A) Qeveria e Serbisë
- B) Qeveria e Greqisë
- C) Qeveria e Durrësit
- D) Qeveria e Italisë

Pyetja 372.

Komiteti “Mbrojtja Kombëtare”, njohu si drejtues të përgjithshëm të çetave çlirimtare në Kosovë (1918-1928):

- A) Sadik Ramën
- B) Adem Reçakun
- C) Elez Isufin
- D) Azem Galicën

Pyetja 373.

“Xhemijeti” u themelua si parti politike në:

- A) Kuvendin e Drenciës (qershor 1920)
- B) Kuvendin e Murgullës (qershor 1920)
- C) Kuvendin themelues të Komitetit të Kosovës (maj 1918)
- D) Kuvendin e Shkupit (dhjetor 1918)

Pyetja 374.

Reforma agrare kolonizuese e viteve '20-30 (shek.XX), në Kosovë shpronësoi:

- A) 1/2 e popullsisë së Kosovës
- B) 1/3 e popullsisë së Kosovës
- C) 1/4 e popullsisë së Kosovës
- D) 1/5 e popullsisë së Kosovës

Pyetja 375.

Sipas të dhënave zyrtare, numri i të shpërngulurve, nga Kosova në Turqi(1918-1941), ishte :

- A) 230 mijë shqiptarë
- B) 235 mijë shqiptarë
- C) 240 mijë shqiptarë
- D) 245 mijë shqiptarë

Pyetja 376.

Nga ngulimet shqiptare të viteve 20-30 (shek.XX), numrin më të madhe të tyre e zinin:

- A) Ngulimet në Itali
- B) Ngulimet në ShBA
- C) Ngulimet në Turqi
- D) Ngulimet në Greqi

Pyetja 377.

Për zhvillimin e Lvizjes Kombëtare gjatë Pavarsisë u shfaq më shume kontributi i :

- A) Arbëreshëve të Italisë
- B) Arbëreshëve të Greqisë
- C) Mërgatës shqiptare të Amërikës
- D) Shqiptarëve të Turqisë

Pyetja 378.

Cila organizatë e emigracionit akreditoi në Evropë (qysh në Luftës Parë Botrore), delegacion në mbrojtje të çështjes shqiptare?

- A) Komiteti i kolonisë së Bukureshtit
- B) Federata “Vatra” në ShBA
- C) Federata “Bijtë e Shqipërisë” në ShBA
- D) Komiteti Nacional Republikan në ShBA

Pyetja 379.

Sipas Statutit Themeltar (Romë, prill 1939), pushtetin legjislativ e ekzekutiv në Shqipëri e ushtronte:

- A) Mbreti i Italisë
- B) Mëkëmbesia e Përgjithëshme
- C) Këshilli i Epërm Fashist Korporativ
- D) Qeveria fashiste e Musolinit

Pyetja 380.

Në procesin e fashistizimit të jetës së vendit rolin drejtues e luante:

- A) Shkolla dhe arsimi
- B) Administrata fashiste
- C) Partia Fashiste e T.Toçit
- D) Instituti shqiptar i studimeve

Pyetja 381.

Vatër e rëndësishme e qëndresës antifashiste sidomos, në vitet e para të pushtimit u bë:

- A) Qëndresa në shkolla
- B) Lëvizja punëtore
- C) Protestat e fshatarësisë
- D) Protestat në diasporë

Pyetja 382.

Lëvizja e armatosur antifashiste, i ka fillimet e veta më krijimin e:

- A) Çetave të armatosura nacionaliste (1940)
- B) Çetës së Pezës (mars 1941)
- C) Çetës partizane të Pezës (gusht 1941)
- D) Atentatin ndaj V. Emanuelit III (maj 1941)

Pyetja 383.

Në mbledhjen themeluese të Partisë Komuniste (8 nëntor 1941) nuk mori pjesë:

- A) Grupi Komunist i Korçës

- B) Grupi Komunist I Shkodrës
- C) Grupi Komunist i të “Rinjëve”
- D) Grupi Komunist i “Zjarrit”

Pyetja 384.

Cila nga këto objektiva nuk parashikohej në programin themelues të Partisë Komuniste

- A) Çlirimi i vendit
- B) Bashkpunimi me forcat e tjera atdhetare
- C) Bashkimi i gjithë popullit në një front antrifashist
- D) Vendosja e diktaturës së proletariatit

Pyetja 385.

Nismën për të hyrë në lidhje me Partinë Komuniste Jugosllave e mori:

- A) Grupi Komunist i Shkodrës
- B) Grupi Komunist i Korçës
- C) Enver Hoxha
- D) Qemal Stafa

Pyetja 386.

Cila rrymë politike nuk u përfaqësua në Konferencën e Pezës (16 shtator 1942)?

- A) Rryma e e Partisë Komuniste e Enver Hoxhës
- B) Rryma zogiste e Abaz Kupit
- C) Rryma nacionaliste e Mithat Frashërit
- D) Rryma e rinisë nacionaliste e H.Begesë

Pyetja 387.

Si datë e saktë për krijimin e organizatës politike “Balli Kombëtar” merret:

- A) Shtator 1942
- B) Dhjetor 1942
- C) Janar 1943
- D) Nëntor 1939

Pyetja 388.

Kryetar i organizatës politike “Balli Kombëtar” (shtator 1942) u zgjodh:

- A) Hysni Lepenica
- B) Skënder Muça
- C) Mithat Frashëri
- D) Ali Këlcyra

Pyetja 389.

Çeta e parë antifashiste e Ballit Kombëtar ishte ajo me komandant:

- A) Hysni Lepenicën (Vlorë)
- B) Safet Butkën (Kolonjë)
- C) Abaz Eremenji (Tomorricë)
- D) Xhelal Staraveckën (Skrapar)

Pyetja 390.

Konferenca e Mukjes (1-3 gusht 1943), ndryshe nga Konferenca e Pezës (16 shtator 1942) u mbajt me synim:

- A) Bashkimin e forcave politike.
- B) Çlirimin e shpejtë të vendit.
- C) Krijimin e një organi lufte të përbashkët
- D) Lidhjen e një aleancë politike dypalëshe

Pyetja 391.

Vendimi për “Krijimin e Komitetit të Shpëtimit të Shqipërisë “ u mor në:

- A) Konferencën e Pezës (shtator 1942)
- B) Konferencën e Mukjes (gusht 1943)
- C) Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare (shtator 1943)
- D) Kongresin Përmetit (maj 1944)

Pyetja 392.

Për herë të parë këshillat nacionalçlirimtarë u shpallën si pushtet i vetëm i ligjshëm në:

- A) Konferencën e Parë të Vendit e PK (MARS 1943)
- B) Konferencën e Mukjes (gusht 1943)
- C) Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare (shtator 1943)
- D) Konferencën e Pezës (shtator 1942)

Pyetja 393.

Regjimi fashist italian dhe regjimi nazist gjerman ruajtë si organ të përbashkët:

- A) Këshilli i Epërm Fashist Korporativ
- B) Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm
- C) Asambleja Kushtetuese
- D) Këshilli i Lartë i Regjencës

Pyetja 394.

Kryetar i Partisë Lëvizja e Legalitetit (21 nëntor 1943) u zgjodh:

- A) Muharrem Bajraktari
- B) Abaz Kupi
- C) Gani bej Kryeziu
- D) Abaz Ermenji

Pyetja 395.

Ndër fuqitë e Mëdha të kohës, interes më të madh për Luftën Antifashiste shfaqti :

- A) Franca
- B) ShBA
- C) Rusia
- D) Anglia

Pyetja 396.

Sipas burimeve, pushtuesit italian e gjenrmanë në Shqipëri angazhuan në luftime:

- A) 160 mijë forca ushtarake
- B) 170 mijë forca ushtarake
- C) 175 mijë forca ushtarake
- D) 180 mijë forca ushtarake

Pyetja 397.

Marrveshja e kompromisit (24 gusht 1944) midis Komandës Aleate të Mesdheut dhe Shtabit të Përgjishëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, nuk përfshiu kërkesën e E.Hoxhës për:

- A) Pranimin e delegacionit shqiptar në Shtabin Aleat
- B) Rritjen e kuotave të furnizimit për Ushtrinë NÇSh
- C) Njohjen e Komitetit Antifashist si qeveri e përkohëshme
- D) Propogandimin e luftës së Frontit ANÇ.

Pyetja 398.

Marrdhënie më të ngushta bashkpunimi, Lëvizja ANÇ vendosi me:

- A) Lëvizjen antifashiste jugosllave
- B) Ushtrinë sovjetike
- C) Lëvizjen antifashistë greke
- D) Lëvizjen antifashiste aleate

Pyetja 399.

Sipas marrëveshjes italo-gjermane të Vjenës (21-22 prill 1941), pjesën më të madhe të Rrafshit të Kosovës e merte:

- A) Gjermania
- B) Bullgaria
- C) Italia
- D) Jugpsllavia

Pyetja 400.

Krijimi i të ashtuquajturës “Shqipëri e Madhe” pati rëndësi të madhe për:

- A) Interesat strategjike të pushtuesit
- B) Zgjidhjen e çështjes kombëtare
- C) Krijimin e "Shqipërisë Etnike
- D) Zbehjen e Luftës ANÇ të shqiptarëve

Pyetja 401.

Kryetar i Komitetit Qëndror të Lidhjes së Prizrenit (janar 1944) u zgjodh:

- A) Rexhep Mitrovica
- B) Bedri Pejani
- C) Fadil Hoxha
- D) Xhafer Deva

Pyetja 402.

Rëndësia e Konferencës së Bujanit (31 dhjetor 1943-2 janar 1944) vlerësohet në historiografi më shumë për rolin që luajti në:

- A) Krijimin e Shtabit Kryesor të Kosovës
- B) Krijimin e Lidhjes II të Prizërenit
- C) Krijimin e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës
- D) Njohjen e Luftës në Kosovë, nga misioni Angles.

Pyetja 403.

Me shpërthimin e luftës italo-greke (1940), tensioni politik në Çamëri arriti pikën kritike për shkak të:

- A) Armatosjes së bandave paramilitare greke
- B) Rekrutimit me forcë të çamëve në ushtrinë greke
- C) Trajtimit të ushtarëve çamë si robër lufte
- D) Burgosjes e shfarosjes të gjithë meshkujve mbi 17 vjeç

Pyetja 404.

Masakra më e madhe e spastrimit etnik nga forcat e N.Zervës në Çamëri konsiderohet ajo e:

- A) Parathimisë (27 qershor 1944)
- B) Pargës (28 gusht 1944)
- C) Filatit (14 shtator 1944)
- D) Korfuzit (13 tetor 1944)

Pyetja 405.

Nga pritshmërit e popullit tonë, mendohej se pas çlirimit (1944) në Shqipëri do të vendosej:

- A) Rregjim federativ
- B) Rregjim monarkik
- C) Rregjim komunist
- D) Rregjim demokratik

Pyetja 406.

Alternativën e zhvillimit socialist të vendit, Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSh) e bëri publike:

- A) Plenumin II (nëntor 1944)
- B) Plenumin IV (nëntor 1945)
- C) Plenumin V (shkurt 1946)
- D) Kongresin I (nëntor 1948)

Pyetja 407.

Në programin vet politik menjëherë pas luftës, PKSh përcaktoi si detyrë prioritare:

- A) Ndërtimin e shtetit të ri
- B) Eliminimin e prapambetjes ekonomike
- C) Kryerjen e Reformës Agrare
- D) Kryerjen e reformave socialiste

Pyetja 408.

Organizata më e madhe politike që u ngrit fill pas Luftës në Shqipëri ishte:

- A) Bashkimi i Rrisë Antifashiste
- B) Bashkimi i Gruasë Antifashiste
- C) Fronti Demokratik
- D) Bashkimi i Sindikal

Pyetja 409.

Subjekti vetëm elektoral që paraqiti kandidatë në zgjedhjet për Asambleen Kushtetuese (dhjetor 1945) ishte:

- A) Partia Komuniste
- B) Fronti Demokratik
- C) Organizata Nacional-Demokratike
- D) Partia Bashkimi Demokrat

Pyetja 410.

Presidiumi i Kuvendit Popullor ishte organ më atributet e :

- A) Kryesisë së Kuvendit Popullor
- B) Kryetarit të Këshillit të Ministrave
- C) Kryetarit të Shtetit
- D) Presidentit

Pyetja 411.

Më 11 janar 1946, Shqipëria u shpall :

- A) Republikë Popullore

- B) Republikë Parlamentare
- C) Republikë Popullore Socialiste
- D) Republikë Popullore Demokratike

Pyetja 412.

Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor (12 janar 1946) u zgjodh:

- A) Enver Hoxha
- B) Dr. Omer Nishai
- C) Haxhi Lleshi
- D) Koçi Xoxe

Pyetja 413.

Në kuadrin e masave për krijimin e pronës së centralizuar, reforma e parë që u ndërmor nga qeveria komuniste, për eliminimin e pronës private ishte:

- A) Kontrolli shtetror- punëtor mbi ndërmarrjet private
- B) Konfiskimi i pasurive të shteteve italiane e gjermane
- C) Anulimi i konçensionit të Bankës Kombëtare
- D) Tatimi i jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës.

Pyetja 414.

Cili nga krerët e Grupit të Deutetëve kundërshtoi Kushtetun e vitit 1946, se përshkohej nga ideologjia komuniste:

- A) Shefqet Beja
- B) Gjergj Kokoshi
- C) Riza Dani
- D) Kostandin Boshnjaku

Pyetja 415.

Cili nga deputetët e organizatës Nacional-Demokratike deklaroi në gjyq: “...kam qënë e jam armik i pushtetit të sotëm”:

- A) Shefqet Beja
- B) Riza Dani
- C) Kolë Kuqali
- D) Enver Sazani

Pyetja 416.

Më 17 nëntor 1945 u krijua organizata antikomuniste:

- A) “Bashkimi Shqiptar “
- B) “Bashkimi Demokratik”
- C) “Nacional Demokratike”
- D) “Demokristiane”

Pyetja 417.

Proçesi i kolektivizimit të bujqësisë në Shqipëri filloi me krijimin

- A) Kooperativës së Risilisë (Vlorë)
- B) Kooperativës Dobraq (Shkodër)
- C) Kooperativës Krutje e Sipërme (Lushnje)
- D) Kooperativës Savër (Lushnje)

Pyetja 418.

Zhvillimi i ekonomisë socialiste me plane pesëvjeçare filloi në:

- A) 1946
- B) 1948
- C) 1949
- D) 1951

Pyetja 419.

Lindjen e arsimit të lartë në Shqipëri e shënoi:

- A) Instituti Pedagogjik 2-vjeçar (1946)
- B) Instituti i Shkencave (1947)
- C) Institutit Pedagogjik 4-vjeçar
- D) Universiteti i Tiranës (1957)

Pyetja 420.

Në përfundim të luftës kundër analfabetizimit (1956) u deklarua se kishin mësuar shkrim e këndim gjithësej:

- A) 165 mijë analfabetë
- B) 175 mijë analfabetë
- C) 185 mijë analfabetë
- D) 190 mijë analfabetë

Pyetja 421.

Për kontributin në Luftën Antifashiste, Shqipëria u thirr të mertë pëjesë, më status vëzhguesi në:

- A) Asamblenë e Përgjithëshme të OKB-s (Londër 1946))
- B) Konferencën e Paqes Parisit (korrik 1946)
- C) Konferencën e San Franciskos (prill 1945)
- D) Konferencën e Reperacioneve (Paris 1945)

Pyetja 422.

Traktati e Paqes me Italinë (dhjetor 1946) e trajtoi Shqipërinë, palë të barabartë në marrdhëniet ndërkombëtare:

- A) Sepse fitoi të dejtën për dëmshpërbilme nga Italia
- B) Sepse Italia detyrohej të respektonte pavarësinë e saj
- C) Sepse u sanksionua si “Fuqi Shoqe” në zbatimin e këtij Traktati
- D) Sepse iu kthye nën sovranitet të plotë Ishulli i Sazanit.

Pyetja 423.

Vendi i parë me të cilin Shqipëria lidhi marrëdhënie diplomatike pas Luftës Dytë Botërore ishte:

- A) Bashkimi Sovjetik
- B) Jugosllavia
- C) Polonia
- D) Bullgaria

Pyetja 424.

Cila nga Fuqitë e Mëdha akreditoi në Shqipëri (më 1945) mission diplomatik civil:

- A) Britania e Madhe
- B) Bashkimi Sovjetik
- C) Shtetet e Bashkuara të Amërikës
- D) Franca

Pyetja 425.

Gjatë lundrimit në Kanalin e Korfuzit (22 tetor 1946), anijet britanike ndeshën në mina nënujore të vendosura nga:

- A) Pushtuesit fashist gjatë Luftës
- B) Nga qeveia shqiptare
- C) Nga qeveria jugosllave
- D) Nga dy qeverit në marrëveshje

Pyetja 426.

Në shtator 1955 Shqipëria u pranua në:

- A) Këshillin e Ndihmës Ekonomike Reciproke (LNER)
- B) Organizatën politiko-ushtarake të Traktatit të Varshavës.
- C) Orgnaizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB)
- D) Organizaten e Sigurimit e Bshkëpunimit European (OSBE)

Pyetja 427.

Emigracioni më i fuqishëm e më aktiv pas luftës ishte ai:

- A) Italisë
- B) Turqisë
- C) ShBA
- D) Gjermanisë

Pyetja 428.

Dokumenti me titull “Tetë Pikat e Nacionalizmit Shqiptar” pas luftës ishte program politik i:

- A) Ballit Kombëtar
- B) Balli Kombëtar Indipendent
- C) Legalitetit
- D) Grupi Demo-Laburist

Pyetja 429

Udhëheqësi dhe ideatori i oragnizatës Balli Kombëtar Indipendent (1946) në Itali ishte:

- A) Mehmet Konica
- B) Ernest Koliqi
- C) Seit Kryesiu
- D) Xhafer Deva

Pyetja 430.

Më 26 gusht 1949 u shpall në Londër:

- A) Komiteti “Evropa e Lirë”
- B) Organizata “Shqipëria e Lirë”
- C) Komiteti Kombëtar “Shqipëria e Lirë”
- D) Programi “Tetë Pikat e Nacionalizmit Shqiptar”

Pyetja 431.

Në krye të Komitetit Kombëtar “Shqipëria e Lirë” u zgjodh:

- A) Hasan Dosti
- B) Mithat Frashëri
- C) Abaz Ermenji
- D) Vasil Andoni

Pyetja 432.

Cili nga drejtuesit e lartë të Partisë Punës të Shqipërisë u deklarua kundër prishjes së marrdhënieve me Bashkimin Sovjetik:

- A) Liri Belishova
- B) Panajot Plaku
- C) Bedri Spahiu
- D) Beqir Balluku

Pyetja 433.

Viti 1967 ka hyrë në histori si viti i:

- A) Eleminimit të institucioneve fetare
- B) Shtetëzimit të ekonomisë zëjtare

- C) Luftës kundër burokratizmit
- D) Luftës me “Fletë-Rrufe”

Pyetja 434.

Shkëputja Shqipërisë nga Blloku Lindor (1960) tërhoqi më shumë vëmëndjen e:

- A) Britanisë e Madhe
- B) Gjermanisë Perëndimore
- C) ShBA-s
- D) Francës

Pyetja 435.

Masa më ekstreme që çoi në eliminimin e plotë të pronës private në fshat ishte:

- A) Reforma Agrare
- B) Reforma e kolektivizimit socialist
- C) Tufëzimi i oborrit kooperativist
- D) Kooperativa e tipit të lartë

Pyetja 436.

Kriza e regjimit komunist mori karakter të përgjithshëm pas:

- A) Reformës së tufëzimit së oborrit kooperativist
- B) Vdekjes tragjike të kryministrit Mehmet Shehu
- C) Krijimit të qeverisë së A.Çarçanit
- D) Ardhjes në krye të PPSH Të Ramiz Alisë

Pyetja 437.

Në vitin 1976, qeveria shqiptare:

- A) Ndërpreu marrdhëniet me Kinën
- B) Shpalli Kushtetutën e RPS të Shqipërisë
- C) Denoncoi Trakatin e Varshavës
- D) Perfundoi elektrifikimin e plotë të vendit

Pyetja 438.

Fundin e regjimit komunist në Shqipëri e shënoi:

- A) Kriza e Ambasadave (korrik 1990)
- B) Shpallja e pluralizmit politik (dhjetor 1990)
- C) Zgjedhjet parlamentare (mars 1991)
- D) Zgjedhjet e parakohëshme (shkurt 1992)

Pyetja 439.)

Sistemi gjigant i fortifikimit (bunkerizimi) të vendit u ndërtua në vitet e qeverisjes së Kryeminsitrit:

- A) Enver Hoxha
- B) Mehmet Shehu
- C) Adil Çarçani
- D) Omer Nishani

Pyetja 440.

Në zhvillimin e levizjes kooperativiste në fshat mbizotroi:

- A) Metoda vullnetare
- B) Metoda e premitimeve
- C) Metoda e propogandës
- D) Metoda e detyrimit dhe dhunës

Pyetja 441.

Sipas historianëve numri i shqiptarëve të shpërngulur nga Kosovë në Turqi është:

- A) 200 mijë vetë
- B) 250 mijë vetë
- C) 300 mijë vetë
- D) 400 mijë vetë

Pyetja 442.

Aneksimi i Kosovës nga Serbia formalisht u vendos nga:

- A) Komiteti Qëndror të PKJ (18 shkurt 1945)
- B) Këshilli Antifashist i Kosovës (10 korrik 1945)
- C) Kuvendi i Prizrenit (9 prill 1945)
- D) Këshilli Antifashist i Serbisë

Pyetja 443. V)

Kërkesa e popullit shqiptar “Kosova Republikë: u shtrua për herë të parë në:

- A) Demonstratat antiserbe të vitit 1948
- B) Demonstratat antiserbe të vitit 1958
- C) Demonstratat antiserbe të vitit 1968
- D) Demonstratat antiserbe të vitit 1981

Pyetja 444.

“Kosova shtet Sovran dhe i pavarur”u ahspall me:

- A) Krijimin e Lidhjes Demokrratike (dhjetor 1989)
- B) Miratimin e Deklaratëas Kushtetuese
- C) Referndumin ep Popullor
- D) Zgjedhjet parlamentare (maj 1992)

Pyetja 445.

Hapin e parë drejt Integritit europian, Shqipëria hodhi me;

- A) Anëtarësimin në OSBE (1991)
- B) Anëtarësimin në Këshillin e Atlantikut Verior (1992)
- C) Anëtarësimin në Paktin e Stabilitetit (qershor 1999)
- D) Nënshkrimin e Paktit Adriatik 3” (2003)

Pyetja 446.

Më 4 prill 2009 Shqipëria:

- A) U pranua në NATO
- B) Nënshkroi MSA
- C) Liberalizoi vizat me BE
- D) U bë vend kandidat i BE

Pyetja 447.

Në mars 1998 në Prekaz:

- A) U krijua Ushtria Çlirimtare e Kosovës
- B) U vra komandanti legjendar Adem Jashari
- C) U shfaq në publi UÇK_ja
- D) U nënshkrua Marrveshja e Rmbujesë

Pyetja 448.

Pavarësia e Kosovës u shpall më:

- A) 24 prill 1999
- B) 12 qershor 1999
- C) 9 qershor 1999
- D) 17 shkurt 2008

Pyetja 449.

Gazeta e parë që shënoi lindjen e shtypit të lirë në Shqipëri (pas vitit 1990) ishte:

- A) “Rilindja Demokratike”
- B) “Republika”
- C) “Koha Jonë”
- D) “Balli Kombëtar”

Pyetja 450.

Organizata ilegale “Lëvizja Rrevolucionare e Bashkimit të Shqiptarëve (1961) drejtohej nga:

- A) Jusuf Gërvalla
- B) Adem Demaçi

- C) Ukshin Hoti
- D) Kadri Osmani

